

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lufta në epokën e fuqive të dobësuara
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/21/lufta-ne-epoken-e-fuqive-te-dobesuara/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:53:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	21 shtator 2026, 13:58:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c119ddd485db1a594aa038dc563378697915c6f8f633391bc6260e82e24d6c09
TEKSTI	dc0a53083e4756dc261da51876f473945b4ca3682efc619641ad5083f9305849
PAMJA	92c2f701637be85d3254a6928bf6cb7823c44ae33b4586dac0a252738c56bae0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c52a2ff6b22cb3df57404d81e946678008527c880ba2ab4f4b49a260abc2629f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/c52a2ff6b22cb3df57404d81e946678008527c880ba2ab4f4b49a260abc2629f

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Project Syndicate

Lufta në epokën e fuqive të dobësuar

Lufta në Iran ka dobësuar si Shtetet e Bashkuara, ashtu edhe Kinën, duke nxjerrë në pah kufijtë e fuqisë së tyre ushtarake dhe të ndikimit të tyre strategjik. Vështirësitë me të cilat përballen këto dy fuqi po krijojnë një peizazh gjeopolitik më të rrezikshëm, ndërsa njëkohësisht i ofrojnë Evropës një mundësi të rrallë për të reformuar modelin e saj të qeverisjes dhe për të riformësuar rolin e saj në skenën globale.



nga Sigmar Gabriel dhe Peter Eitel — 2 days më parë në Project Syndicate

AA

0

Koha e leximit: 5 min lexim



Një anije në Ngushticën e Hormuzit. Foto: Wikimedia Commons.

Vendimi i Shteteve të Bashkuara dhe i Izraelit për të nisur luftë kundër Iranit po rezultojnë jetë një pikë kthese në ekuilibrin global të fuqisë, duke i lënë si SHBA-në, ashtu edhe Kinën më të dobëta se më parë. Në Evropë nuk ka arsye për ta parë këtë si diçka për t'u përshëndetur, sepse modeli aktual evropian nuk është i përshtatur për t'u mbrojtur në një botë të rrezikshme, ku fuqitë e mëdha po dobësohen.

Ndërsa përpjekja e Presidentit amerikan Donald Trump për ta detyruar Iranin të zbrapsset përmes forcës ushtarake ka dështuar keq dhe ka nxjerrë në pah kufijtë e fuqisë amerikane. Por lufta ka dobësuar edhe Kinën. Bllokadat që vazhdojnë në Ngushticën e Hormuzit dhe në Detin e Kuq po pengojnë furnizimet dhe tregtinë, duke i shtuar barrën problemeve strukturore me të cilat përballen tashmë Kina: borxhi i lartë publik, një kurs këmbimi i mbajtur artificialisht i ulët, papunësia e të rinjve, pabarazia ekonomike dhe plakja e popullsisë. Nëse Kina nuk e përmbysh objektivin e saj të rritjes, apo edhe nëse e arrin atë vetëm me vështirësi, regjimi i Presidentit Xi Jinping mund të gjendet gjithnjë e më shumë nën presion dhe i kufizuar në hapësirën e veprimit.

Ndryshe nga kjo, lufta në Ukrainë ka qenë një mundësi ekonomike për Kinën. Furnizimet me naftë dhe gaz nga Rusia dhe Irani, pavarësisht sanksioneve, e kanë ndihmuar Kinën të përmbyshë nevojat e saj të mëdha energjetike, ndërsa ajo ka përballuar shumë pak nga kostot e garantimit të rrugëve detare të tregtisë. Kina ka përfutur gjithashtu ndjeshëm nga shitja e mallrave me përdorim të dyfishtë Rusisë. Energjia e lirë, së bashku me një monedhë të nënvlerësuar artificialisht dhe një ekonomi të mbështetur nga kreditimi i subvencionuar, i ka mundësuar Kinës të ruajë nivelet e prodhimit dhe konkurrueshmërinë e kostove, pavarësisht dobësimit të kërkesës së brendshme.

Tani lufta në Iran kërcënon ta përmbyshë këtë situatë të favorshme për Kinën. Kina, importuesja më e madhe e naftës në botë, jo vetëm që humbi brenda natës një pjesë të konsiderueshme të furnizimeve të saj energjetike, por zbuloi edhe se sa i kufizuar është ndikimi i saj mbi "partnerët" e vet. Pavarësisht marrëdhënieve të veçanta me Iranin, Kina nuk ka arritur ta bindë Republikën Islamike të rihapë Ngushticën e Hormuzit ose, të paktën, të lejojë kalimin e anijeve kineze.

Ndërkohë, për SHBA-në, lufta me Iranin përbën një katastrofë në politikën e jashtme dhe në fushën e sigurisë kombëtare. Asnjë nga objektivat e saj ushtarake nuk është arritur, kostoja që u ngarkohet taksapaguesve është jashtëzakonisht e lartë dhe nuk duket fundi i konfliktit.

Kuvendi injoron konsultimet publike, fut në shqyrtim Reformën Territoriale

16:11 | 23/09/2026

Avokati i Netanyahu-t mes drejtuesve të kompanisë që prodhon dronë izraelitë në Serbi

15:08 | 23/09/2026

Eurodeputetja i kërkon qeverisë që të mos zvarrisë ndryshimet në ligjin 21/2024

14:26 | 23/09/2026

A mund të ndjekim Hungarinë në hetimin e pasurive të zyrtarëve?

12:20 | 23/09/2026

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

06:20 | 23/09/2026

Rama shkarkon Hysenin, por shmang përgjegjësitë për skandalin në SHISH

16:31 | 22/09/2026

Si Kina, ashtu edhe SHBA-ja po bëhen gjithnjë e më të varura nga borxhi për të mbuluar problemet e tyre themelore. Një botë në të cilën edhe dy superfuqitë janë dobësuar është një vend i rrezikshëm. Ndërsa fuqia dhe ndikimi i tyre zbehen, aktorë dhe aleanca të reja po nxitohen të mbushin vakuumin e krijuar. Aleanca e mbrojtjes e nënshkruar së fundmi ndërmjet Turqisë, Arabisë Saudite dhe Pakistanit është një shembull domethënës.

Dobësimi i fuqisë amerikane dhe kineze i krijon Bashkimit Evropian një mundësi për të riformësuar rolin e tij në skenën globale, por deri tani BE-ja duket kryesisht e kënaqur me retorikën boshe. Megjithatë prej kohësh synon të shndërrohet në një fuqi gjeopolitike, BE-ja vazhdon të mbetet e zhytur në mosmarrëveshje të vogla dhe nuk arrin as ta çlirojë ekonominë e vet nga ngërçi i pengesave burokratike që e frenojnë.

Evropa mund t'i vajtojë këto ndryshime dhe të qëndrojë mënjanë, ose mund ta shfrytëzojë këtë mundësi për t'u shndërruar në një fuqi gjeopolitike. Por kjo kërkon që ajo të mbrojë interesat e veta, të zbatojë reforma strukturore gjithëpërfshirëse, të forcojë kapacitetet e saj mbrojtëse dhe të sigurojë rrugët strategjike detare të tregtisë, si dhe zinxhirët e furnizimit me lëndë të para.

Për të ruajtur rëndësinë e saj në skenën globale, BE-ja duhet gjithashtu të rishqyrtojë modelin e saj të qeverisjes. Diversiteti i saj është njëkohësisht pasuria më e madhe dhe dobësia më e madhe e Unionit, pasi modeli aktual kërkon konsensusin e 27 shteteve anëtare, interesat e të cilave nuk përputhen gjithmonë. Rezultati është një proces i mundimshëm dhe i zgjatur, në të cilin nevoja për t'i kënaqur të gjithë bën që politikat rrallë të shkojnë përtej nivelit të përbashkët minimal. Shtetet anëtare që ndajnë të njëjtin qëndrim kanë pak hapësirë për të marrë drejtimin në çështje të caktuara, ndërsa nismat e tyre shpesh pengohen nga presioni për të gjetur zgjidhje që të vlejnjë për të gjithë Bashkimin Evropian.

Kjo këmbëngulje për uniformitet shtrihet edhe në marrëdhëniet me vendet jashtë BE-së. Marrëdhënia e Unionit me Mbretërinë e Bashkuar pas Brexit-it është një shembull i tillë, ashtu si edhe negociatat e zgjatura për marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe për forcimin e marrëdhënieve me Kanadanë, Australinë dhe Zelandën e Re.

Asgjë nga këto nuk duhet të vijë si befas: projekti evropian lindi nga nevoja për ta mbrojtur Evropën nga vetvetja, duke kapërcyer ndarjet shekullore. Sot, megjithatë, Evropa duhet të mbrohet nga kërcënimet e jashtme – një sfidë thelbësisht e ndryshme, për të cilën modeli i saj aktual nuk është i përshtatshëm.

Udhëheqësit evropianë mund të nxjerrin mësim nga sektori privat. Ashtu si në rastin e Evropës, edhe për korporatat e mëdha forca e tyre më e madhe – një portofol shumë i larmishëm produktesh – ishte shndërruar në dobësinë e tyre më të madhe. Mbatja e të gjitha produkteve dhe shërbimeve nën një strukturë të centralizuar ishte bërë tepër e kushtueshme dhe e ngathët. Zgjidhja ishte t'u jepej njësive individuale më shumë autonomi, duke ruajtur njëkohësisht kontrollin ligjor mbi bizneset kryesore. Kalimi nga konglomeratet e integruara drejt strukturave të ngjashme me kompanitë holding u dha shumë kompanive më tepër fleksibilitet dhe efikasitet, duke ulur kostot dhe barrën administrative.

Natyrisht, modeli i korporatave nuk mund të zbatohet drejtpërdrejt në marrëdhëniet ndërmjet shteteve. Por BE-ja mund të përvetësojë logjikën që qëndron në themel të tij dhe t'u ofrojë partnerëve demokratikë më shumë se zgjedhjen dypolare midis anëtarësimit të plotë dhe qëndrimit jashtë Unionit, duke parë nga brenda. Mundësia e niveleve të ndryshme të integritimit mund të hapë rrugë për mundësi të reja, veçanërisht për vende si Turqia, e cila prej dekadash pret të anëtarësohet në BE, por që vështirë se do të bëhet anëtare në një të ardhme të afërt.

Sado i pamundur politikisht të duket reformimi i BE-së, ia vlen të kujtojmë se 70 vjet më parë pak njerëz do ta kishin imagjinuar Unionin në formën që ka sot. Nëse Evropa dëshiron të shmangë përsëritjen e kapitujve më të errët të historisë së saj, ajo duhet të synojë sërish të arrijë atë që duket politikisht e pamundur. Në një epokë fuqish dobësuar, kjo do të thotë se ajo duhet të rishqyrtojë mënyrën se si është e organizuar, në mënyrë që të përmbushë rolin që dëshiron të luajë në botë.

Marrë me autorizim nga [Project Syndicate](#), 2016. Ripublikimi mund të bëhet vetëm me lejen e [Project Syndicate](#). [War in an Age of weak Powers](#)

Etiketa: Bashkimi Evropian Donald Trump Irani Izraeli Kina Ngushtica e Hormuzit
SHBA Xi Jinping